



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	25.04.2025
Nga:	ZPP Gentiana Qela 
PER:	PRO MEDICAL SH.P.K
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K të datës 18.04.2025 kundër njoftimit per kontrate për procedure të prokurimit me numër 611-25-2667-1-2-1, me titull “ Paisje stomatologjike per nevoja te QKMF” datës 02.04.2025 , Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K të datës 15.04.2025 kundër njoftimit per kontrate të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-2667-1-2-1 me titull “Paisje stomatologjike per nevoja te QKMF” e datës 02.04.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin per kontrate të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K.. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Zyra e Prokurimit ne kordinim me komisionin per hartimin e specifikave ka shqyrtuar kerkesen tuaj dhe ka ofruar keto sqarime :

Për këtë arsye, kërkojmë që ky specifikim teknik të mos merret në konsideratë, pasi nuk është në përputhje me standardet aktuale të tregut, dhe propozojmë që ai të hiqet nga specifikimet teknike pra "Tubi I siguresave: T3A"

Tek pozicioni 6 si me poshtë ju keni cekur si:

6 Kompresori ajrit pa vaji , pa zhurëm1 cope

1. Kapaciteti 50-60 lit. ne minut
2. Motorri 650-750 Ë
3. Shtypja 0.8Mpa deri 1 Mpa
4. Voltazha 220V-240V 50Hz
5. Tank (kapaciteti) min. 35 lit.
6. Pesha 25-28 kg
7. Zhurma 60-65 dB

Tek pika 1, keni specifikuar një kapacitet prej 50–60 litra në minut, por kur kemi të bëjmë me një tank me kapacitet 35L, sipas standardeve, kapaciteti i prodhimit të ajrit është 150 L/min, çka përfaqëson një zgjidhje më të avancuar.

Përgjigjia: Kapaciteti 50-60l , këto vlera yi përshtaten kapacitetit të tankut të kompresorit 30l të cilat nuk përjashtohet mundësia të janë më të larta

Tek pika 2, modeli që keni përfshirë, edhe pse përmban gabime, varion sipas standardeve nga 650–850Ë, dhe kjo duhet të reflektohet në specifikimet teknike.

Përgjigjia: Motorri 650-750W varion nga kapaciteti

Tek pika 7, për nivelin e zhurmës 60–65 dB, ju e keni prezantuar kompresorin si "pa zhurmë", ndërkohë që kjo vlerë është mbi kufirin e lejuar. Sipas standardeve, niveli i zhurmës nuk duhet të kalojë 55 dB, prandaj kërkohet një pajisje me zhurmë më të ulët sesa ajo që keni përshkruar.

Përgjigjia: Zhurma 60-65db vlerat më të ulëta nuk përjashtohen mirëpo maksimalja është 65db

Kunder ketij vendimi keni te drejte ankese ne OSHP ne afate prej 10 Dite .